

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

➤ OLIVE CLINIC

➤ HANDIKOS FERIZAJ

Çdo njeri meriton kujdes, respekt dhe shëndet të mirë. Ju jeni pjesë e rëndësishme e shoqërisë sonë dhe ne jemi këtu për të ecur bashkë me ju, duke ju ofruar mbështetje dhe kujdes të vazhdueshëm. Kjo marrëveshje synon të lehtësojë qasjen në shërbime shëndetësore cilësore për personat me nevoja të veçanta, duke ofruar mbështetje të vazhdueshme dhe profesionale.

Në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet Olive Clinic dhe Handikos Ferizaj (Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara), të gjithë anëtarët e Handikos Ferizaj përfitojnë këto lehtësira shëndetësore:

NENI 1 : SHËRBIME FALAS NË MJEKËSINË FAMILJARE:

- Vizita te mjeku i përgjithshëm;
- Terapi parenterale : I.M ; I.V ; S.C; I.D;
- Inhalime;
- Pastrim plagësh.

NENI 2 : VIZITA FALAS TE SPECIALISTËT:

- Kardiolog;
- Endokrinolog;
- Nefrolog;
- Reumatolog;
- Internist;
- Fiziatër.

NENI 3 : 50% ZBRITJE NË ANALIZAT LABORATORIKE:

- Hematologji;
- Biokimi;
- Mikrobiologji;
- Hormonale.

NENI 4 : 20% ZBRITJE NË SHËRBIMET E FIZIOTERAPISË

NENI 5 : 20% ZBRITJE NË TË GJITHA SHËRBIMET E MJEKËSISË FAMILJARE DHE LABORATORIKE PËR NJË (1) KUJDESTAR TË PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Neni 6:

Kjo marrëveshje hyn në fuqi nga data e nënshkrimit dhe është e vlefshme për (6) gjashtë muaj , me mundësi vazhdimi me marrëveshje të ndërsjellë.

Neni 7:

Për të përfituar nga shërbimet e përcaktuara në këtë marrëveshje, anëtarët e Handikos Ferizaj dhe Kujdestari i tyre duhet të identifikohen përmes një dokumenti referues nga Handikos Ferizaj (**Libreza e anëtarësimit**)

Neni 8:

Palët caktojnë nga një person përgjegjës për komunikim dhe koordinim të përbashkët për zbatim të marrëveshjes.

Neni 9:

Palët pajtohen kjo marrëveshje mund të publikohet në kanale zyrtare mediatike.

Olive Clinic Ferizaj
Dr. Florent Grainca
Kordinatori pikës



Handikos Ferizaj
Z. Enver Kosumi

Drejtor Ekzekutiv



Datë: 09.09.2025
Ferizaj